



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec



RAHOVEC / ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 376 Nr. i faq./Br.str./No.pg 01

Data/Datum/Date 23.09.2022

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17 shkronja g) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), dhe nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.7 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt.23.09.2022 miraton këtë :

V E N D I M

Për lirim nga taksa komunale për persona fizik dhe juridik për vlerësimin e dëmeve në bujqësi nga komisioni

1. Me këtë vendim **LIROHEN** nga taksa komunale personat fizik dhe juridik për vlerësimin e dëmeve në bujqësi nga komisioni nga periudhën prej datës 19 shtator 2022 deri me datë 14 tetor 2022 në shumën prej 10€ (dhjetë euro) të përcaktuar me nenin 34 paragrafi 4 pika 1 të Rregullores për Taksa Komunale 01 Nr. 80/20 e datës 29.06.2020.
2. Lirimi nga taksa komunale sipas pikës 1 të këtij vendimi bëhet me qëllim që t'u dilet në ndihmë bujqëve të Komunës së Rahovecit, për shkak të vërshimeve nga shirrat e rrembyeshëm të cilat kanë ndodhur me datë 17 shtator 2022 në territorin e Komunës së Rahovecit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- **Kryetarit të Komunës,**
- **Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural,**
- **MAPL-së, dhe**
- **Arkivit.**

01-Nr.376/22
Datë: 23.09.2022

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

